



**STATUTI I DHOMES SE TREGTISE
DHE INDUSTRISE
QARKU TIRANE**

	Faqe
KREU I – DISPOZITA TE PERGJITHSHME	
Neni 1 Objekti i Statutit	3
Neni 2 Statusi juridik, Selia dhe Vula	3
Neni 3 Objekti i Veprimtarisë së Dhomës	3
Neni 4 Kompetencat e Dhomës	4
Neni 5 Forma të bashkëpunimit dhe të integritimit	4
KREU II – ORGANET DREJTUESE	
Neni 6 Asambleja	5
Neni 7 Kompetencat e Asamblesë	6
Neni 8 Funksionimi i Asamblesë	6
Neni 9 Kryesia e Dhomës	7
Neni 10 Kompetencat e Kryesisë	8
Neni 11 Funksionimi i Kryesisë	8
Neni 12 Kryetari i Dhomës	9
Neni 13 Funksionet dhe kompetencat e Kryetarit	9
Neni 14 Sekretari i Dhomës dhe kompetencat e tij	9
Neni 15 Komisioni i Auditimit	10
KREU III – ANETARESIA E DHOMES	
Neni 16 Anëtarësimi në Dhomë	10
Neni 17 Regjistri i Anëtarëve	11
Neni 18 Kuota vjetore e anëtarësimit	11
KREU IV – ORGANIZIMI I DHOMES SE TREGTISE DHE INDUSTRISE QARKU TIRANE	
Neni 19 Zyra e përfaqësimit	11
Neni 20 Struktura e administratës së Dhomës	12
Neni 21 Shërbimet që kryen administrata	12
Neni 22 Struktura organizative dhe drejtuesit ekzekutivë	12
Neni 23 Konsulenca e ekspertëve të jashtëm	13
KREU V – ADMINISTRIMI FINANCIAR	
Neni 24 Parime të përgjithshme	13
Neni 25 Burimet financiare të Dhomës	13
Neni 26 Disponimi i pasurive të paluajtshme	
KREU VI – DISPOZITA TE FUNDIT	
Neni 27 Ndryshimi i Statutit	14
Neni 28 Hyrja në fuqi e Statutit	14

Dhoma e Tregtise dhe Industrise Qarku Tirane, qe ne vazhdim do te qubet "Dhoma", eshte person juridik qe ushtron veprimtarine e saj bazuar ne ligjin Nr. 9640 date 9.11.2006 "Per Dhomat e Tregtise dhe Industrise" dhe te legjislacionit shqiptar ne fuqi. Dhoma e Tregtise dhe Industrise Tirane krijohet dhe funksionon brenda Qarkut Tirane.

Statuti i Dhomës përcakton parimet mbi të cilat bazohet aktiviteti i Dhomës si dhe kompetencat, funksionet dhe përbërjen e organeve të saj.

KREU I DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1 Objekti i Statutit

Ky Statut përcakton parimet bazë të funksionimit të Dhomës, personaliteti juridik, objektivat, dhe kompetencat e së cilës rregullohen nga Ligji nr. 9640 "Per Dhomat e Tregtise dhe Industrise".

Neni 2 Statusi Juridik, Selia dhe Vula

Dhoma e Tregtise dhe Industrise Tirane eshte person juridik, qe nuk ushtron veprimtari fitimprurëse. Selia e Dhomës ndodhet në Tiranë Rr. e Kavajes Nr.6. Selia e Dhomës mund të ndryshojë me vendim të organeve drejtuese të saj.

Dhoma ushtron aktivitetin e saj në Qarkun e Tiranës dhe kompetencat e saj shtrihen brenda territorit të ketij qarku sipas përcaktimit të Ligjit nr.8653 "Per ndarjen administrativo-territoriale" me ndryshimet perkatese.

Stema zyrtare e Dhomës paraqet ne menyre te stilizuar kullen e Sahatit ne qender te Tiranës. Vula zyrtare e Dhomës është ne formë të rrumbullakët, me diameter 35 mm në qendër vendoset stema e Dhomës, rreth së cilës shkruhet: "Republika e Shqipërisë, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë * Tirana-Albania*".

Neni 3 Objekti i Veprimtarisë së Dhomës

Dhoma e Tregtise dhe Industrise-Qarku Tirane, brenda kompetencave të përcaktuara në ligjin "Për Dhomat e Tregtisë", është e pavarur në realizimin e objektit kryesor të veprimtarisë së saj si dhe në ushtrimin e detyrave të caktuara.

Dhoma ushtron brenda territorit të saj, funksione në mbështetje të interesave të pergjithshme ekonomike të anëtarëve të saj, me përjashtim të kompetencave që ligji ia njihet administratës shtetërore dhe asaj lokale.

Gjatë veprimtarisë së saj, Dhoma nxit veprimtarinë tregtare e industriale në territorin e qarkut, si dhe bashkëpunimin ekonomik dhe tregtar me vendet e tjera.

Dhoma shkëmben vazhdimisht informacione me administratën publike në nivel qendror dhe lokal, për nxitjen dhe zhvillimin e bizneseve në territorin ku ushtron veprimtarinë.

Një objektiv tjetër i veprimtarisë së Dhomës është promovimi dhe realizimi i shërbimeve me interes të pergjithshëm, në dobi të anëtarëve të saj.

Dhoma ushtron gjithshu funksione që i delegohen nga pushteti qendror dhe ai lokal, si dhe ato që parashikohen nga marrëveshjet ndërkombëtare.

Neni 4 **Kompetencat e Dhomës**

Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë ka këto kompetenca:

1. Ndërmerr çdo veprimtari, që i shërben nxitjes dhe mbrojtjes së tregtisë e industrisë, në përputhje me objektin e veprimtarisë së saj dhe legjislacionin në fuqi;
2. Jep mendime, propozime dhe vlerësime për nismat ligjore apo politikat publike, të ndërmarra nga administrata qendrore, vendore dhe subjektet e tjera publike, përmbajtja e të cilave prek interesat e anëtarëve të saj.
3. Informon autoritetet përkatëse shtetërore për çështje të ndryshme, me qëllim parandalimin e konkurrencës së pandershme;
4. Mbikëqyr zbatimin e rregullave të pjesëmarrjes në panaire ndërkombëtare jashtë vendit nga subjektet tregtare, që përfaqësojnë vendin tonë në këto panaire;
5. Organizon dhe/ose merr pjesë në panaire dhe ekspozita me karakter vendor, kombëtar dhe ndërkombëtar;
6. Krijon komisione këshilluese për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet anëtarëve të saj;
7. Nxit dhe ndihmon anëtarët e Dhomës për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, tregtare dhe civile, nëpërmjet rrugës së ndërmjetësimit dhe arbitrazhit;
8. Mban regjistrin e anëtarësisë si dhe kryen funksione të tjera administrative në shërbim të anëtarëve të saj;

Neni 5 **Forma të bashkëpunimit dhe të integrimit**

Për arritjen e objektivave të saj, Dhoma bashkëpunon me administratën shtetërore, qendrore dhe lokale, me institucione ndërkombëtare si dhe me shoqata dhe organizata të biznesit, vendase dhe të huaja.

Dhoma mund të marrë pjesë dhe të nënshkruajë marrëveshje dhe protokolle bashkëpunimi, të jetë pjesëmarrëse në programe dhe në projekte të ndryshme në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, me qëllim zhvillimin dhe integrimin europian dhe më gjerë të sipërmarrjes shqiptare.

Si anëtare e Bashkimit të Dhomave të Tregtisë, Dhoma merr pjesë në të gjitha inisiativat që kanë për synim zhvillimin dhe promovimin e biznesit shqiptar.

Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, mund të anëtarësohet në organizma ndërkombëtarë të dhomave të tregtisë si ICC (International Chamber of Commerce), Eurochambres etj.

Dhoma gjithashtu mund të krijojë marrëdhënie partneriteti me dhoma të tjera të huaja, në kuadrin e programeve të përbashkëta.

KREU II ORGANET DREJTUESE

Neni 6 Asambleja

Asambleja është organi më i lartë vendimmarrës i Dhomës. Ajo zgjidhet për një periudhë 4-vjeçare nga bashkësia e anëtarëve të Dhomës. Asambleja e Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë të Qarkut Tiranë përbëhet nga 101 anëtarë.

Asambleja e Dhomës zgjidhet nga bashkësia e anëtarëve të Dhomës, duke siguruar përfaqësimin e grupeve të biznesit sipas aktiviteteve:

- Tregti;
- Ndërtim;
- Prodhim/industri;
- Shërbime;
- Transport-telekomunikacion.

Zgjedhjet organizohen të veçanta për çdo grup biznesi.

Përfaqësimi i veprimtarive të mësipërme bëhet në atë përqindje që zë çdo grup, kundrejt numrit të përgjithshëm të anëtarësisë në Dhomë.

Anëtarët e asamblesë janë persona, që kanë zotësi të plotë për të vepruar, gëzojnë reputacion në komunitetin e biznesit të zonës, që përfaqësojnë, dhe nuk kanë qenë të dënuar, me vendim gjykate të formës së prerë, për vepra penale.

Anëtarët e asamblesë duhet të jenë të autorizuar nga subjekti tregtar, që përfaqësojnë, për të përfaqësuar dhe ushtruar të drejtën e votës në asamblenë e Dhomës. Çdo subjekt tregtar ka të drejtë të përfaqësohet në asamblenë e Dhomës vetëm nga një anëtar.

Anëtari i Asamblesë e humbet mandatin kur:

- Kur shkel dispozitat e këtij ligji dhe të ligjeve të tjera në fuqi, si dhe statutin e Dhomës;
- Nëse brenda dt.31 Mars të vitit në vazhdim nuk ka paguar kuotën vjetore të anëtarësisë;
- Subjekti të cilin përfaqëson, nuk ekziston më për shkak falimentimi, apo mbyllje të aktivitetit me vendim gjykate;
- Nuk merr pjesë, pa pasur një motiv të justifikueshëm, në dy mbledhje të zakonshme të njëpasnjëshme të Asamblesë;
- Kur jep dorëheqjen;
- Është në pamundësi për të ushtruar mandatin e tij (arsye shëndetësore, personale etj);
- Dënohet nga gjykata me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

Në rastin e largimit të një anëtari të Asamblesë, vendin e tij e zë personi i renditur me më shumë pikë në listën përfundimtare të votimit të grupit përkatës të biznesit (pas anëtarëve të Asamblesë të këtij grupi). Ku mbaron lista e kandidaturave të mundshme, atëherë Asambleja vendos të bëhen zgjedhje të pjesshme për atë grup biznesi, me qëllim plotësimin e vendeve në Asamble.

Mandati i anëtarit të ri zgjat deri në përfundim të mandatit 4-vjeçar të Asamblesë.

Zgjedhjet për Asamblenë e ardhshme duhet të zhvillohen brenda 45 ditëve para përfundimit të mandatit të Asamblesë aktuale.

Asambleja, në mbledhjen e saj të fundit, miraton rregullat dhe procedurat për zgjedhjen e Asamblesë së re, të cilat hartohen dhe propozohen nga Kryesia.

Neni 7 Kompetencat e Asamblesë

Asambleja përcakton drejtimit kryesore të veprimtarisë së Dhomës si dhe kontrollon dhe nxjerr aktet përkatëse, në zbatim të ligjit dhe të këtij Statuti.

Asambleja në veçanti ka këto kompetenca:

1. Shqyrton dhe përcakton drejtimit kryesore të veprimtarisë së Dhomës.
2. Miraton statutin dhe ndryshimet e tij dhe ia dërgon ato për miratim ministrit që mbulon tregtinë.
3. Zgjedh nga anëtarët, me votime të fshehta e të veçanta, kryesinë, kryetarin e Dhomës, përfaqësuesit e Dhomës në asamblenë e Bashkimit të Dhomave, si dhe anëtarët e komisionit të auditimit.
4. Përcakton shpërblimet për kryetarin e Dhomës dhe komisionin e auditimit.
5. Miraton programin dhe buxhetin vjetor të Dhomës .
6. Shqyrton e miraton raportin vjetor të veprimtarive në përgjithësi, dhe të veprimtarisë financiare të Dhomës.
7. Miraton masën e kuotizacionit vjetor të anëtarëve.
8. Miraton akte të ndryshme për funksionimin dhe organizimin e Dhomës.

Neni 8 Funksionimi i Asamblesë

Mbledhjet e asamblesë janë të zakonshme dhe të jashtëzakonshme.

Asambleja e zakonshme mbledhet të paktën një herë në vit, brenda muajit Mars, për aprovimin e projektbuxhetit dhe programit të vitit në vazhdim.

Mbledhja thirret nga kryetari, me kërkesë të kryesisë së Dhomës, e cila cakton edhe rendin e ditës së mbledhjes së asamblesë. Kur kryetari, brenda 15 ditëve nga marrja e kërkesës, nuk mbledh asamblenë, atëherë kryesia e Dhomës ka të drejtë ta mbledhë vetë asamblenë, duke e lajmëruar për datën, orën, vendin dhe rendin e ditës së mbledhjes. Dërgimi i materialeve dhe njoftimi për datën e mbledhjes bëhet të paktën një javë para ditës kur do të zhvillohet

mbledhja. Ky njoftim, përfshirë dhe materialet e mbledhjes, mund të kryhet dhe në formë elektronike në internet, në faqen zyrtare të Dhomës.

Mbledhjet e asamblesë përfaqësuese drejtohen nga Kryetari i Dhomës.

Asambleja e jashtëzakonshme mbledhet me kërkesë të kryetarit dhe/ose kryesisë, apo kur këtë e kërkon 1/3 e anëtarëve të saj. Rendi i ditës së asamblesë së jashtëzakonshme caktohet nga kërkuesi/t.

Kur kryetari, brenda 15 ditëve nga marrja e kërkesës nga subjektet e përcaktuara në paragrafin më lart, nuk mbledh asamblenë, atëherë kërkuesi ka të drejtë ta mbledhë vetë atë, duke e lajmëruar për datën, orën, vendin dhe rendin e ditës së mbledhjes.

Mbledhja e asamblesë është e vlefshme kur në të marrin pjesë më tepër se gjysma e anëtarëve të saj. Vendimet janë të vlefshme kur për to votojnë pro më shumë se gjysma e anëtarëve të pranishëm (50%+1).

Statuti dhe ndryshimet e tij miratohen me shumicën e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Asamblesë (minimalisht 52 vota).

Votimi mund të jetë i hapur ose i fshehtë. Kur votimi është i hapur, anëtarët e Asamblesë shprehin votën me gojë ose duke ngritur dorën.

Në mbledhjet e Asamblesë nuk lejohet delegimi në pjesëmarrje dhe në votim.

Vendimet e Asamblesë shënohen në një procesverbal, i cili nënshkruhet nga kryetari i Dhomës dhe sekretari i mbledhjes i cili është punonjës i administratës së Dhomës dhe emërohet nga Kryetari.

Asambleja krijon Komisionin e Mandateve i cili verifikon respektimin e mandatit, shqyrton të gjitha çështjet që lidhen me mandatin të anëtarit si dhe paraqet raportin përkatës në Asamble.

Asambleja mund të krijojë dhe komisione të tjera të veçanta, të përbëra nga vetë anëtarët e Asamblesë, me qëllim trajtimin e çështjeve me rëndësi për aktivitetin e Dhomës. Këto Komisione kanë një rol rekomandues dhe propozues, dhe mund të jenë të përhershme (gjatë gjithë mandatit të Asamblesë), ose të përkohshme.

Neni 9 Kryesia e Dhomës

Kryesia e Dhomës përbëhet nga Kryetari i Dhomës dhe nga 14 anëtare, të cilët zgjidhen me votim të fshehtë nga Asambleja. Kryesia zgjidhet për një periudhë katërvjeçare, që përputhet me kohëzgjatjen e mandatit të Asamblesë.

Në Kryesi sigurohet përfaqësimi i të pesë grupeve të biznesit (tregti, industri, shërbime, transport-telekomunikacion dhe ndërtimi).

Anëtarët e Kryesisë (me përjashtim të Kryetarit), nuk mund të jenë funksionarë ekzekutivë në administratën e Dhomës.

Humbja e mandatit si anëtar i Asamblesë sjell automatikisht humbjen e mandatit si anëtar i Kryesisë.

Neni 10 **Kompetencat e Kryesisë**

Kryesia është organi ekzekutiv i Dhomës. Ajo ka këto kompetenca:

- a) Miraton programet e punës, që lidhen me detyrat dhe objektivat e Dhomës.
- b) Miraton strukturën organizative të aparatit administrativ të Dhomës, funksionet dhe pagat e punonjësve të këtij aparati.
- c) Miraton rregulloren e brendshme të aparatit administrativ të Dhomës.
- ç) Shqyrton programin vjetor financiar dhe buxhetin përpara se t'i paraqitet asamblesë për miratim.
- d) Cakton shpërblimet për shërbimet, që kryejnë ekspertët e jashtëm.
- dh) Cakton rregullat për përdorimin e fondeve dhe administrimin e tyre.
- e) Propozon ndryshimet në statutin e Dhomës.
- ë) Përcakton rendin e ditës së mbledhjes së asamblesë së Dhomës.
- f) Merr vendime për të gjitha çështjet, që shtrohen për shqyrtim në kryesi nga kryetari dhe/ose sekretari i Dhomës.

Kryesia është përgjegjëse për:

- zbatimin e vendimeve të asamblesë;
- mbarëvajtjen e veprimtarisë së Dhomës.

Neni 11 **Funksionimi i Kryesisë**

Kryesia, si rregull, mbledhet jo më pak se një herë në muaj nga kryetari i Dhomës ose me kërkesë të 1/3 së anëtarëve. Njoftimi dhe dërgimi i materialeve bëhet të paktën 7 ditë para datës së caktuar për mbledhje.

Mbledhja e kryesisë është e vlefshme kur në të marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve. Mbledhja e Kryesisë drejtohet nga kryetari. Kryesia zgjedh midis anëtarëve të saj, një përfaqësues që do të drejtojë mbledhjet e saj në rastet kur mungon Kryetari.

Vendimet e kryesisë janë të vlefshme kur për to votojnë pro më shumë se gjysma e anëtarëve të pranishëm në mbledhje. Në çdo rast nuk pranohet delegimi i votës.

Vendimet e kryesisë nënshkruhen nga kryetari ose, në mungesë të tij, nga anëtari i caktuar për të drejtuar mbledhjen.

Kryesia nxjerr çdo akt tjetër, për realizimin e funksionit dhe veprimtarisë së saj, të parashikuar nga ligji ose statuti, kur nxjerrja e aktit nuk hyn në kompetencat e asamblesë ose të kryetarit.

Anëtari i Kryesisë, që nuk merr pjesë në katër mbledhje gjatë vitit kalendarik, humbet të drejtën për të qënë anëtar i Kryesisë në vazhdim të mandatit të saj. Anëtari zëvendësues zgjidhet nga Asambleja.

Në mbledhjet e Kryesisë mund të marrin pjesë, pa të drejtë vote, edhe Sekretari dhe anëtarët e Komisionit të Auditimit (këta të fundit vetëm kur diskutohen çështje që kanë të bëjnë me financat e Dhomës). Gjithashtu në mbledhje mund të ftohen të marrin pjesë dhe funksionarë të administratës së dhomës, prania e të cilëve është e domosdoshme për çështjet që do të trajtohen.

Neni 12 **Kryetari i Dhomës**

Kryetari i Dhomës zgjidhet me votim të fshehtë nga Asambleja, për një periudhë katërvjeçare. Kryetari zgjidhet midis anëtarëve të Asamblesë, brenda 10 ditësh nga formimi i Asamblesë . Kryetar i Dhomës mund të zgjidhet çdo shtetas shqiptar, që ka zotësi të plotë për të vepruar, ka mbaruar arsimin e lartë, si dhe ka treguar aftësi të dukshme në fushën e biznesit, në fushat akademike apo në administrim.

Kryetari i Dhomës pas përfundimit të mandatit, gëzon të drejtën të jetë anëtar i Asamblesë së ardhshme, pa iu nënshtruar procedurave të zgjedhjes.

Kryetari drejton veprimtarinë e Dhomës dhe kryesinë e saj. Ai është përfaqësuesi ligjor i Dhomës në marrëdhëniet me të tretët, si dhe përgjigjet për aktivitetin, administrimin dhe funksionimin e Dhomës.

Ai është funksionar dhe paguhet nga Dhoma.

Neni 13 **Funksionet dhe kompetencat e Kryetarit**

Kryetari kryen këto funksione:

-Përfaqëson Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë të Qarkut Tiranë në të gjithë aktivitetet që kryen kjo e fundit, si dhe në takime zyrtare të nivelit të lartë, delegacione qeveritare, etj.

-Thërret dhe drejton mbledhjet e Asamblesë dhe të Kryesisë;

-Paraqet çdo vit para Asamblesë raportin vjetor të aktivitetit të Dhomës si dhe projektprogramin për vitin e ardhshëm;

-Organizon, drejton dhe mbikqyr drejtpërsëdrejti aktivitetin e administratës së Dhomës, si dhe ndan detyrat për çdo departament apo njësi tjetër të kësaj administrate, sipas përcaktimeve të Rregullores së Dhomës.

-Organizon punën për zbatimin e vendimeve të Asamblesë dhe të Kryesisë;

-Cakton dhe delegon përfaqësues të Dhomës në organizma, komisione borde etj, ku Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë është anëtare.

-Përfaqëson Dhomën në marrëdhëniet e punësimit.

Neni 14 **Sekretari i Dhomës dhe kompetencat e tij**

Sekretari i Dhomës emërohet dhe shkarkohet me urdhër të ministrit përgjegjës për tregtinë.

Sekretari i Dhomës duhet të jetë shtetas shqiptar, me arsim të lartë dhe të mos ketë qenë i dënuar, me vendim gjykatë të formës së prerë, për vepra penale.

Sekretari i Dhomës është funksionar me kohë të plotë dhe paguhet nga buxheti i Dhomës.

Sekretari i Dhomës ka këto kompetenca:

1. Njofton periodikisht organin mbikëqyrës për veprimtarinë e Dhomës.
2. Ndjek respektimin nga Dhoma të dispozitave të këtij ligji dhe të ligjeve të tjera në fuqi.
3. Ndjek zbatimin e vendimeve të kryesisë dhe të asamblesë së Dhomës.
4. Ndjek procedurat e regjistrimit të anëtarësisë së subjekteve tregtarë në Dhomë;
5. Ushtron çdo kompetencë tjetër, të parashikuar me ligj.

Në rastet kur vëren shkelje të ligjshmërisë në vendimet e marra nga organet e Dhomës njofton organin mbikëqyrës, i cili brenda 30 ditëve nga vënia në dijeni, u kërkon këtyre organeve rishikimin e vendimeve të marra.

Neni 15 **Komisioni i Auditimit**

Komisioni i auditimit zgjidhet për një periudhë 4-vjeçare dhe përbëhet nga 3 anëtarë, nga të cilët njëri është ekspert kontabël i autorizuar dhe emërohet nga ministri përgjegjës për tregtinë, ndërsa dy të tjerët zgjidhen nga asambleja e Dhomës, njëri me profesion jurist dhe tjetri me profesion ekonomist. Në mbledhjen e tij të parë Komisioni zgjedh kryetarin e tij. Në rastin kur një nga anëtarët e zgjedhur të Komisionit nuk mund të ushtrojë detyrën, Kryetari i Dhomës fillon procedurat për zgjedhjen e anëtarit të ri nga Asambleja.

Me ftesë të Kryetarit të Dhomës, anëtarët e Komisionit të Auditimit marrin pjesë në mbledhjet e Kryesisë.

Për kryerjen e aktivitetit të tij, Komisioni bashkëpunon me administratën e Dhomës. Për këtë qëllim Komisionit i vihet në dispozicion çdo akt dhe dokument administrativ dhe financiar i Dhomës.

Komisioni i auditimit ka për detyrë të kontrollojë, në vazhdimësi, veprimtarinë ekonomiko-financiare të Dhomës dhe të raportojë në mbledhjen vjetore të asamblesë për administrimin e mjeteve dhe të burimeve financiare të Dhomës. Raportet e Komisionit miratohen dhe firmosen nga të paktën dy prej anëtarëve të tij.

Pas miratimit në Asamble raportet e komisionit të auditimit i dërgohet për njoftim organit mbikëqyrës.

Me kërkesë të Kryetarit, të Asamblesë dhe të Sekretarit të Dhomës, komisioni mund të ushtrojë kontroll tematik.

Anëtarët e Komisionit të Auditimit mbajnë përgjegjësi për aktet e kontrollit dhe detyrat që kryejnë gjatë mandatit të tyre.

KREU III ANETARESIA E DHOMES

Neni 16 Anëtarësimi në Dhomë

Anëtarësia në dhomë është vullnetare për personat juridikë dhe fizikë, të regjistruar në regjistrin tregtar, sipas legjislacionit në fuqi.

Anëtarësimi është i përvitshëm dhe fillon nga data 1 Janar dhe përfundon në 31 Dhjetor. Anëtarët e Dhomës pajisen me certifikatën e anëtarësimit.

Organet tatimore, gjatë veprimtarisë së tyre kontrolluese, detyrojnë subjektet tatimore që të jenë anëtare të Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë, sipas ligjit për dhomat e tregtisë.

Neni 17 Regjistri i Anëtarëve

Dhoma mban regjistrin e anëtarësisë. Të dhënat e regjistrit duhet të jenë në formë të shkruar dhe elektronike. Forma e unifikuar e këtij regjistri dhe mënyra e mbajtjes së tij përcaktohen nga Asambleja e Bashkimit të Dhomave.

Neni 18 Kuota vjetore e anëtarësimit

Anëtarësimi në Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë është i ndarë në 4 kategori si më poshtë:

Anëtar “GOLD”

Anëtar “VIP”

Anëtar “Biznes I Madh”

Anëtar i Thjeshtë.

Kriteret për anëtarësimin dhe shërbimet suplementare për çdo kategori, përcaktohen nga Kryesia e Dhomës.

Anëtarët e Dhomës paguajnë kuotën vjetore të anëtarësisë. Masa e kuotës vjetore të anëtarësimit në Dhomë përcaktohet nga Asambleja me vendim të veçantë. Asambleja, çdo vit, mund të bejë rishikimin e masës së kuotës .

KREU III
ORGANIZIMI I DHOMES SE TREGTISE DHE INDUSTRISE QARKU
TIRANE

Neni 19
Zyra Përfaqësimi

Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Qarku Tiranë ka një zyrë përfaqësimi në qytetin e Kavajës. Zyra e përfaqësimit Kavajë kryen regjistrimin e subjekteve tregtarë që kryejnë aktivitet në territorin që mbulon Bashkia Kavajë dhe Rrogozhinë. Gjithashtu kjo zyrë kryen dhe lëshimin e çertifikatave jopreferenciale të origjinës dhe çdo detyrë tjetër që i ngarkohet nga Kryetari i Dhomes.

Stafi i Zyrës së përfaqësimit Kavajë është pjesë e strukturës organizative të Dhomës dhe për punonjësit zbatohen të njëjtat kritere si për punonjësit e Dhomës.

Neni 19/1

Krijimi i agjencive dhe qendrave të specializuara

1. Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tirane, mund të krijojë agjenci dhe qendra të specializuara, me qëllimin për të ushtruar kompetencat që ka Dhoma sipas Ligjit Nr.9640 Neni 5, si dhe për të kryer shërbimet e nevojshme për arritjen e objektivave institucionale. Këto agjenci ose qendra themelohen dhe funksionojnë sipas normave të drejtës private.
2. Agjencite dhe qendrat e specializuara, të krijuara nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tirane, kanë statutin e tyre si dhe organizim të veçantë administrativ. Statuti i tyre aprovohet me shumicë të thjeshtë nga Asambleja e Dhomes së Tregtisë dhe Industrisë Tirane
3. Veprimtaria financiare e agjencive dhe qendrave të specializuara është objekt i kontrollit nga ana e Komisionit të Auditimit të Dhomes.

Neni 20
Struktura e administratës së Dhomës

Struktura organizative, dhe shërbimet që kryen Dhoma, rregullohen nga ky statut si dhe nga rregullorja e brendshme e administratës së Dhomës, e cila aprovohet nga Kryesia me propozim të Kryetarit.

Organizimi i strukturës dhe shërbimeve bëhet në përputhje me objektivat e veprimtarisë së Dhomës. Veprimtaria ekzekutive e Dhomës drejtohet dhe mbikëqret nga Kryetari.

Neni 21

Shërbimet që kryen administrata

Në përmbushje të objektivave dhe funksioneve të Dhomës, administrata kryen këto aktivitete dhe shërbime:

- Jep mendime, propozime dhe vlerësime për nismat ligjore apo politikat publike, të ndërmarra nga administrata qendrore, vendore dhe subjektet e tjera publike, përmbajtja e të cilave prek interesat e anëtarëve të saj.
- Vendos, mban dhe zhvillon kontakte me dhomat homologe, me institucione ekonomike, shoqata, organizata dhe firma jashtë vendit me qëllim nxitjen e tregtisë dhe bashkëpunimit ekonomik me to.
- Informon anëtarët e saj mbi mundësitë dhe kërkesat e tregut në vendin tonë dhe atë ndërkombëtar, mbi tendencën e zhvillimit të tregut, konkurrencën, për zhvillimin e ankandëve e tenderave të ndryshëm etj.
- Dhoma organizon dhe administron misionet biznesi, ekspozita e panairë, kurse trajnimi profesionale, si dhe çdo veprimtari tjetër që i shërben nxitjes së tregtisë e të industrisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- Mban regjistrin e anëtarëve të Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Qarku Tiranë, me të dhënat përkatëse për çdo anëtar, si dhe pajis anëtarët me çertifikatën e anëtarësisë.
- Pergatit kontrata model, forma dhe kushte të përgjithshme për kontrata për lloje të ndryshme aktiviteteve ekonomike.
- Informon mbi legjislacionin tregtar të Republikës së Shqipërisë dhe atë ndërkombëtar si dhe mbi marrëveshjet e tregtisë që ka nënshkruar vendi ynë me shtetet e tjera.
- Nxit dhe ndihmon anëtarët e Dhomës për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, tregtare dhe civile, nëpërmjet rrugës së ndërmjetësisë dhe arbitrazhit;
- Lëshon çertifikatën e origjines jopreferenciale të mallrave si dhe dëshmi të tjera që kërkohen në shkëmbimet ekonomike sipas legjislacionit në fuqi.
- Kryen funksionin e agjentit të autorizuar në kuadrin e mbrojtjes së pronësisë industriale.

si dhe kryen çdo veprimtari apo shërbim tjetër, që i ngarkohet me ligj apo me akte nënligjore.

Neni 22

Struktura organizative dhe drejtuesit ekzekutivë

Struktura organizative e administratës së Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Tiranë përbëhet nga:

- Kabineti i Kryetarit
- Departamentet
- Zyrat

Departamentet dhe zyrat janë njësi organizative e strukturës së Dhomës, me kompetenca administrative dhe ekzekutive. Departamentet dhe zyrat organizojnë, administrojnë dhe drejtojnë punën me objekt të përcaktuar, në përputhje me rolin dhe me funksionin sipas rregullores së brendshme të Dhomës. Drejtuesit e Departamenteve dhe Zyrave janë përgjegjës për organizimin dhe drejtimin e punës në njësinë organizative që u është besuar.

Përcaktimi konkret i departamenteve, zyrave dhe detyrave të tyre bëhet në strukturën dhe rregulloren e Dhomës.

Emërimi i punonjësve të administratës së Dhomës bëhet nga Kryetari, sipas strukturës organizative dhe nivelit të pagave të miratuara nga Kryesia. Marrëdhëniet e punës të administratës së Dhomës rregullohen nga Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë.

Neni 23

Konsulenca e ekspertëve të jashtëm

Dhoma mund të kërkojë konsulencën e ekspertëve të jashtëm për çështje specifike që kërkojnë trajtim profesional. Për këtë qëllim mund të lidhen kontrata dhe marrëveshje bashkëpunimi me ekspertët. Kryetari i Dhomës, në stafin e tij mund të mbajë dhe këshilltarë të jashtëm me profil ekonomik apo juridik.

Shpërblimet për shërbimet që kryejnë ekspertët dhe këshilltarët e jashtëm përcaktohen nga Kryesia.

KREU V

ADMINISTRIMI FINANCIAR

Neni 24

Parime të përgjithshme

Administrimi financiar i Dhomës bazohet në ligjin “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, në akte të tjerë ligjorë dhe nënligjorë si dhe në standartet kombëtare të kontabilitetit. Viti financiar fillon në 1 Janar dhe përfundon në 31 Dhjetor.

Aktiviteti financiar i Dhomës bazohet në programimin e shpenzimeve dhe të të ardhurave, që pasqyrohen në projektbuxhetin e Dhomës.

Neni 25

Burimet financiare të Dhomës

Të ardhurat e Dhomës realizohen nëpërmjet:

1. kuotizacionit vjetor të anëtarëve të Dhomës;
2. shërbimeve nga veprimtaria e Dhomës;
3. kontributeve të donatorëve, vendas dhe të huaj;
4. burimeve të tjera si të ardhura nga projektet etj, të cilat nuk bien ndesh me legjislacionin shqiptar.

Tarifat e shërbimeve që kryen Dhoma (dhënie e certifikatës jopreferenciale të origjinës, tarifa për pasaportat e shërbimit, notat verbale, tarifat e regjistrimit të markave dhe patentave etj) miratohen nga Kryesia.

Neni 26
Disponimi i pasurive të paluajtshme

Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë mund të fitojë në pronësi dhe të administrojë pasuri të paluajtshme, në përputhje me Kodin Civil dhe legjislacionin shqiptar në fuqi.

KREU VI
DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 27
Ndryshimi i Statutit

Dispozitat e këtij Statuti mund të ndryshohen me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Asamblesë. Çdo ndryshim i Statutit i njoftohet organit mbikqyrës, për t'u shprehur për ligjshmërinë e tij.

Neni 28
Hyrja në fuqi e Statutit

Ky Statut miratohet me vendim të Asamblesë së Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Qarku Tiranë, në date 22 Shkurt 2007.

K R Y E T A R I

Prof. Gjokë ULDEDAJ